

FOTO PERSONALE

BIOGRAFIA /CURRICULUM VITAE/

1. Mbiemri:	Rexhaj
2. Emri:	Besim
3. Nacionaliteti:	Shqiptar
4. Shtetësia:	Kosovar
5. Data e Lindjes:	17/03/1960
6. Gjinia:	Mashkull
7. Detajet kontaktuese:	
<i>Email:</i>	brexhaj@yahoo.co.uk
<i>Tel:</i>	044 113 974
8. Niveli Arsimor:	
<i>Institucioni:</i>	Fakulteti i Filologjisë, Letërsi dhe Gjuhë Shqipe
<i>Data e diplomimit:</i>	1987
<i>Diploma :</i>	Struktura e romanit «Vdekja më vjen prej syve të tillë» i Rexhep Qosjes
<i>Institucioni:</i>	Fakulteti i Filologjisë, Letërsi dhe Gjuhë Shqipe
<i>Data e diplomimit:</i>	1993
<i>Diploma/ Magjistratura :</i>	Tipologjia e dramës së sotme shqiptare në Kosovë 1950 -1990
<i>Institucioni:</i>	Fakulteti i Filologjisë, Dega e Letërsisë dhe Gjuhës Shqipe
<i>Data e diplomimit:</i>	2006
<i>Diploma/ Doktorata :</i>	Tipat e dramës së sotme shqiptare, 1948 -2000
9. Titulli akademik:	Profesor i Asocuar
<i>Institucioni:</i>	Fakulteti i Arteve, Drejtimi i Arteve Dramatike
<i>Data e zgjedhjes:</i>	Nëntor i vitit 2011
10. Krijimtaria artistike	
<p>Në vitin 2011, në kuadër të shtëpisë së njohur botuese “Faik Konica”, më është botuar Trilogjia Vorbulla, e cila përbëhet nga tri vepra dramatike, përkatësisht nga dy monodrama, Portreti i pakryer dhe Loja e pafund, dhe një dramë e titulluar Vorbulla. Drama Vorbulla, e shfaqur si premierë në datën 25 shkurt të vitit 2014 në Teatruin Kombëtar në Prishtinë.</p>	
Ekspozitat personale/ Koncertet solistike / Rolet Kryesore – Kombëtare dhe Ndërkombëtare	
<p>Në kuadër të aktiviteteve dhe të prezencës sime në fushë të dramës e të jetës teatrore, do të përmendja pjesëmarrjen time në Festivalin Ndërkombëtar të Teatrove, Kosova Infest,</p>	

International Theater Festival, Prishtinë, të mbajtur në muajin Tetor të vitit 2010, në të cilin kam marrë pjesë edhe si moderator i tryezave të festivalit, në të cilat kanë marrë pjesë regjisorët, producentët dhe aktorët kryesor ndërkombëtar të shfaqjeve të këtij Festivali. Krahas kësaj, i kam përcjellë me analiza, interpretime dhe vlerësime të gjitha shfaqjet e këtij Festivali, të cilat, siç mund të shihet edhe nga njësitë bibliografike, janë botuar në Gazetën Koha Ditore gjatë muajit tetor të vitit 2010.

Në vitin 2011, në kuadër të **Manifestimit kulturor artistik me karakter kombëtar** “Flaka e Janarit”, në të cilin përfaqësohen vepra artistike nga e gjithë shtrirja kombëtare, kam marrë pjesë në programin e aktivitetit teatror, si pjesa qendrore e këtij manifestimi, në cilësi të Kryetarit të Jurisë Profesionale të këtij Edicioni të këtij Manifestimi.

Në vitin 2012, po ashtu, në cilësi të anëtarit të Jurisë Profesionale, kam marrë pjesë në **Festivalin Gjithëkombëtar të Teatrorë** në Ferizaj, që është Festivali me traditën më të gjatë kohore si festival me karakter kombëtar te ne e në të cilin marrin pjesë me krijimet e veta teatrore përfaqësues nga e gjithë hapësira kulturore shqiptare.

Në vitin 2012, në organizim të A mbasadës së Suedisë në Shkup, në 100 vjetorin e vdekjes së dramaturgut të madh suedez, nga data 5 e deri në datën 10 nëntor 2012, në kuadër të bashkëpunimit ndërkulturor të universiteteve të rajonit, në Festivalin Ndërkombëtar SKOMRAHI, kam marrë pjesë me ligjëratën **August Strindbergu në kulturën dhe teatrin shqiptare (August Strindberg in Albanian Culture and Theater** , ligjëratë kjo e mbajtur në gjuhën angleze para ekspertëve dhe regjisorëve e studentëve nga rajoni e më gjerë, e cila mund të evidentohet përmes makinës së kërkimit Google nëse shënohet emri dhe mbiemri im si dhe August Strindberg.

Ekspozitat kolektive/ Koncerte të përbashkëta/ Rolet dytësore–Kombëtare dhe ndërkombëtare

Publikime të tjera

Unë, Besim Rexhaj kam lindur në Pejë, në vitin 1960, ku edhe kam kryer shkollimin fillor dhe të mesëm, Gjimnazin Klasik. Kam diplomuar në Degën e Letërsisë dhe të Gjuhës Shqipe të Fakultetit të Filologjisë, Universiteti i Prishtinës, më 1987. Në po këtë Fakultet, përkatësisht në Degën Letërsi dhe Gjuhë Shqipe, kam vazhduar mësimet pasuniversitare dhe, më 1993, kam marrë gradën e Magjistrisë të Shkencave Filologjike me temën **Tipat e dramës së sotme shqiptare në Kosovë 1950 – 1990**, e cila botohet si libër në vitin 1994 në Bibliotekën e njohur “Hejza” të Rilindjes, Prishtinë, libër ky që është libri i parë me karakter studimor e sintetik i botuar në Kosovë, i cili merret

ekskluzivisht me dramën dhe i trajton problemet e dramës, të teatrit e të dramaturgjisë kombëtare në Kosovë nga një perspektivë e tillë.

Punën time të mëtejme studimore e kam vazhduar me hulumtime në fushë të dramës e të dramaturgjisë dhe, krahas botimeve nëpër revistat dhe gazetat tona të vëzhgimeve e të analizave të mia, në Fakultetin e Filologjisë, në vitin 2006, Dega Letërsi dhe Gjuhë Shqipe, kam mbrojtur tezën e doktoratës me temën **“Tipat e dramës së sotme shqiptare, 1948 -2000”**.

Veprimtaria ime në fushë të publicistikës dhe të studimit daton që nga mesi i viteve '80-të dhe, në fillim të vitit 1990 kam filluar të punoj në Ndërmarrjen “Rilindja”, në Redaksinë e Revistave, në Revistën për Kulturë, Art e Letërsi “FJALA”, si redaktor deri në fund të vitit 1999. Krahas punës sime si redaktor, kam bashkëpunuar me shumicën e revistave shkencore e kulturore të vendit si dhe me të përditshmet tona me shkrime autoriale lidhur me problemet kulturore, gjuhësore, artistike dhe shkencore, një pjesë e të cilave më janë botuar në librin **“Kosova në mes”** (Monizmi, Pluralizmi, Pushtimi) në vitin 1992, në Prishtinë.

Nga viti 1996 kam filluar të punoj si bashkëpunëtor në Fakultetin e Arteve, Dega e Arteve Dramatike, Universiteti i Prishtinës, dhe kam ligjëruar, deri në vitin 1999, lëndën e Historisë së Teatrit dhe të Dramës Kombëtare, kurse nga viti 1999 e deri më sot e ligjëroj lëndën Histori e Dramës dhe e Teatrit Botëror I dhe II, për të tri drejtimet në kuadër të punës së rregullt në Fakultetin e Arteve, Drejtimi i Arteve Dramatike. Krahas kësaj lënde, e ligjëroj edhe lëndën Histori e Dramës dhe e Teatrit Kombëtar I dhe II. Si rezultat i angazhimit tim të përhershëm në studimin e dramës, të teatrit e të dramaturgjisë, në vitin 2009 është botuar libri monografik në dy vëllime **“Drama Shqiptare pas Luftës së Dytë Botërore, 1948 – 2008, Poetika, Tipologjia, Periodizimi**, (637 faqe), i cili e ka fituar shpërblimin e Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës, “Pjetër Bogdani” si libri më i mirë i vitit në të gjitha zhanret e letërsisë për vitin 2008/09.

Në vitin 2011, në kuadër të shtëpisë së njohur botuese “Faik Konica”, më është botuar Trilogjia **Vorbulla**, e cila përbëhet nga tri vepra dramatike, përkatësisht nga dy monodrama, **Portreti i pakryer** dhe **Loja e pafund** dhe një dramë e titulluar **Vorbulla**. Drama **Vorbulla**, e shfaqur si premierë në datën 25 shkurt të vitit 2014 në Teatruin Kombëtar në Prishtinë.

Deri më tani kam botuar një numër njësisish bibliografike, ndër të cilat po theksojmë:

- analiza teatrore e shfaqjes **“Aleksandër Mojsiu”** inskenuar nga Teatri Kombëtar, në regji të Agim Selimit, teksti i shkruar nga Musa Ramadani, Bota sot, 23.4. 2006;
- vështrimi analitik **“Në shenjë të satirës dhe të paradisë”**, Bota sot, 14.5 2006;
- vështrimi **“Refuzimi estetik i çështjeve jothelbore”**, Lajm ekskluziv, 25. 8. 2006;
- vështrim **“Teatri elizabetian – në shenjë të teatrit të Shekspirit**, revista Albanica, Nr. 58/59, Korrik-gusht, 2006;

- vështrim studimor “**Bertold Breht – dramatisi dhe teoriku paradoksal**”, Lajm ekskluziv, 26.9. 2006;
- **Bekim Fehmiu, yll i madh i qiellit tonë** - analizë e portretit artistik, revista Albanica, nr. 61, tetor 2006;
- vështrim studimor “**Një zë i ri dramaturgjik origjinal**”, Stefan Çapaliku “Ftesë për darkë”, Bota sot, 13.8.2006;
- vështrim analitik “**A kemi një strategji kulturore mbarëkombëtare**”, revista Albanica nr. 62 nëntor 2006;
- **vështrim analitik, “Krijuesi, i cili i mungon letërsisë shqiptare”, i lexuar më 28 tetor 2007, në manifestimin e organizuar nga Lidhja e Shkrimtarëve e Kosovës, në 70-të vjetorin e lindjes së Anton Pashkut;**
- **August Strindberg – profili biografik dhe krijues**, prezantim; Loja, Nr. 3, Revistë për Teatër, 2008;
- vështrim analitik “**Njeriu në kurthin e paradokseve**”, mbi njëaktëshen e August Strindbergut, “E forta”, Loja, Nr. 3, Revistë për Teatër, 2008;
- Prof. Dr. Besim REXHAJ, **Paradokset e nocionit Kosovë si topikë gjeoletrare dhe Kosova në raport me tërësinë e letërsisë shqiptare në dritën e kësaj topike, Kumtesë e lexuar në Seminarin e 27-të Ndërkombëtarë për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, Prishtinë, 2008;**
- vështrim studimor “**Aktualiteti i pacenuar i krijuesit – ose dramaturgjia e Azem Shkreli**”, i lexuar më 25 Maj 2009 në Takimet Letrare “Azem Shkreli”, Pejë;
- Prof. Dr. Besim REXHAJ, **Drama shqiptare pas Luftës së Dytë Botërore, 1948 – 2008, Poetika, Tipologjia, periodizimi**, Shtëpia Botuese “Faik Konica”, Prishtinë, 2009, **Studim monografik, Libër në dy vëllime, 637 faqe;**
- Prof. Dr. Besim REXHAJ, **Paradokset e nocionit Kosovë si topikë gjeoletrare dhe Kosova në raport me tërësinë e letërsisë shqiptare në dritën e kësaj topike, botuar në: Universiteti I Prishtinës, Fakulteti i Filologjisë, Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, 28/2, Prishtinë, 2009;**
- Prof. Dr. Besim REXHAJ, **Aspekte të dramaturgjisë të fillimit të shekullit tonë**, Kumtesë e lexuar në Seancën e Dytë të Takimit të Katërtë vjetor të Institutit ALB-SHKENCA (4-th Annual Meeting of Institute Alb-Shkenca), 31 gusht, 2009;
- Prof. Dr. Besim REXHAJ, **Figurshmëria e gjuhës së poezisë – midis strategjisë artistike dhe asaj politike, kumtesë e lexuar në Seminarin e 29-të Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe**

Kulturën Shqiptare, Prishtinë, 2009;

Prof. Dr. Besim REXHAJ, **Lidhja shqiptare e Prizrenit në dramaturgjinë bashkëkohore shqiptare – aspekte të trajtimit të saj**, Kumtesë e lexuar në **Festivalin Ndërkombëtar “Drini Poetik”(Poetic Drini)**, më 10 qershor 2010, në shënimin e 132 vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit në Prizren;

Prof. Dr. Besim REXHAJ, **Lidhja shqiptare e Prizrenit në dramaturgjinë bashkëkohore shqiptare – aspekte të trajtimit të saj**, botuar në **Revistën për Letërsi, Metafora**, Nr. 1, Lidhja e Shkrimtarëve e Kosovës, Prishtinë, 2010;

Prof. dr. Besim Rexhaj, **Drama e prostitucionit si dramë e shumëfishtë e realitetit shqiptar**, Kumtesë e lexuar në **Konferencën e V-të vjetore Ndërkombëtare të Institutit Alb-Shkenca**, Prishtinë, më 1-2, tetor 2010;

Vështrime dramaturgjike e teatrore:

Besim Rexhaj, **Aktualiteti i dramaturgjisë së Havelit**, vështrim mbi dramën e Vaclav Hvellit “Tri vuajtjet e Vanekut”, Koha ditore, 5 tetor 2010, Prishtinë;

Besim Rexhaj, **Drama mbi vorbullën e ankthit ekzistencial të shkrimtarit**, Bobok, dramatizim i novelës së Fjodor Dostojevskit, Koha ditore, 6 tetor 2010, Prishtinë;

Besim Rexhaj, **Në shenjë të performancës së digjitalizuar**, Koha Ditore, 7 Tetor 2010, Prishtinë;

Besim Rexhaj, **Në shenjë të një koncepti të kufizuar regjisorial**, vështrim mbi shfaqjen “Vladimiri dhe Kosara”, Zagorka Pop Antoska Andovska, Koha Ditore, 8 Tetor 2010, Prishtinë;

Besim Rexhaj, **Midis monodramës dhe performancës bashkëkohore**, vështrim mbi shfaqjen teatrore “Kujtimet e Natës”, Matias Rutiman, Koha Ditore, 9 Tetor 2010, Prishtinë;

Besim Rexhaj, **Midis spektaklit dhe dramës politike**, vështrim mbi shfaqjen teatrore “Beselam pse me flijojnë”, Rexhep Qosja, Koha Ditore, 10 Tetor 2010, Prishtinë;

Besim Rexhaj, **Potenca krijuese në shfaqjen “Kush ka frikë nga Virginia Woolf”**, vështrim mbi shfaqjen teatrore “Kush ka frikë nga Virginia Woolf”, Edward Albee, Koha Ditore, 11 Tetor 2010, Prishtinë;

Besim Rexhaj, **Një shfaqje e pazakonshme dhe e veçantë teatrore**, vështrim mbi shfaqjen “Këmisha e gjakut”, Bekim Lumi, Koha Ditore, 23 Tetor 2010, Prishtinë;

Prof. Dr. Besim REXHAJ, **Figurshmëria e gjuhës së poezisë – midis strategjisë artistike dhe asaj politike**, kumtesë e botuar në **Seminarin e 29/2 Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare**, Prishtinë, 2010;

Prof. Dr. Besim Rexhaj, **Figurshmëria e poezisë, midis strategjisë artistike dhe asaj politike**,

qasje socio – politike, Koha Ditore, 4 Dhjetor 2010, Prishtinë;

Besim Rexhaj, **Një shfaqje e pazakonshme dhe e veçantë teatrore**, vështrim mbi shfaqjen “Këmisha e gjakut”, Bekim Lumi, Loja, Revistë për Teatër, nr. 5, 2010, Prishtinë;

Besim Rexhaj, **Paradokset e nocionit KOSOVË SI TOPIKË GJEOLETRARE**, Qasje socio – politike, Kosova Sot, 15 Janar 2011, Prishtinë;

Prof. Dr. Besim Rexhaj, **Drama e prostitucionit, si dramë e shumëfishtë e realitetit shqiptar**, vështrim analitik, Koha Ditore, 19 Mars 2011, Prishtinë;

Prof. Dr. Besim Rexhaj, **Drama e prostitucionit, si dramë e shumëfishtë e realitetit shqiptar**, vështrim analitik, Koha Ditore, 26 Mars 2011, Prishtinë;

Dr. Besim Rexhaj, **Vetëvrasja si akt proteste, revolte dhe refuzimi qytetar**, ese në njëvjetorin e vetëvrasjes së Bekim Fehmiut, Kosova Sot, 18 Qershor 2011, Prishtinë;

Prof. Dr. Besim REXHAJ, **Paradokset e jetës teatrore kombëtare, Qasje dhe observacione sociokulturore**, Kumtesë e lexuar në Debatin e PEN Qendrës së Kosovës, mbajtur në Teatrin Kombëtar, në organizim të PEN Qendrës së Kosovës në muajin Dhjetor, 2011;

Prof. Dr. Besim REXHAJ, Analizë, **Paradokset e jetës teatrore kombëtare, Qasje dhe observacione sociokulturore**, botuar në Shtojcën për Kulturë të së përditshmes Kosova Sot, 24 Dhjetor 2011;

Besim REXHAJ, **Një komedi ndryshe**, analizë teatrore mbi komedinë “Lisistrata” të Arisrtofanit, inskenuar nga Teatri Kombëtar, në regji të Elmaze Nurës, botuar në Shtojcën për Kulturë të gazetës Koha Ditore, 28 prill 2012;

Prof. Dr. Besim REXHAJ, **Letërsia dhe Sfida e Integrimit Shpirtëror Kombëtar**, Kumtesë e lexuar në Festivalin Ndërkombëtar të Poezisë, Drini Poetik (Poetic Drini), Sesioni i Kumtesave për Letërsinë, qershor, 2012;

Prof. Dr. Besim REXHAJ, **Një studim dhe një qasje shumëdimensionale**, vështrim mbi monografinë e Prof. Dr. Mahmud Hysajt, Polifonia e tekstit letrar, Libri shkollor, Prishtinë, 2012, botuar në Shtojcën për Kulturë të gazetës Koha Ditore, 30 qershor 2012;

Besim REXHAJ, **Letërsia përballë sfidës së integrimit shpirtëror kombëtar**, qasje sociopolitike, botuar në Shtojcën për Kulturë të gazetës Koha Ditore, 8 shtator 2012;

Prof. Dr. Besim REXHAJ, **Aspekte të modelimit të mendimit kritikues në fushën e dramaturgjisë shqiptare**, Kumtesë, **Seminari 31, 2012** kumtesë e lexuar në seminarin **31 Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare**, 2012, Prishtinë;

Prof. Dr. Besim REXHAJ, **Aspekte të modelimit të mendimit kritikues në fushën e dramaturgjisë shqiptare**, kumtesë e botuar në seminarin **31/2 Ndërkombëtar për Gjuhën**,

Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare 2012, Prishtinë, 2012;

Prof. Dr. Besim REXHAJ, **Aspekte të identitetit letrar, kumtesë e lexuar në seminarin 32 Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, 2013**, Prishtinë, e cila është përfshirë në programin e zakonshëm të botimit të librit të Seminarit në vitin 2014.

Prof. Dr. Besim REXHAJ, **Letërsia dhe Sfida e Integritit Shpirtëror Kombëtar**, Metafora, Revistë Letrare, Nr. 2, Prishtinë, 2013;

Besim REXHAJ, **Në shenjë të aktrimit të sofistikuar**, analizë teatrore për shfaqjen “Pas Zonjushës Julia” të Patrick Marber, regjia e Kushtrim Koliqit, inskenuar nga Teatri Kombëtar, Prishtinë, Shtojca për Kulturë e gazetës Koha Ditore, 20 prill, 2013

Besim REXHAJ, **Drama e (vet)mashtrimit të intelektualit**, analizë teatrore mbi dramën e Stefan Çapalikut, Fausti prej Tirane, në regji të Stefan Çapalikut dhe Alfred Trebickës, e shfaqur edhe në Teatrin Dodona, Prishtinë, botuar në Portalin Teelegraf, 24 nëntor 2013, dhe në Koha Ditore, Shtojca për Kulturë, 1 Dhjetor 2013.

Përkthime të dramave, eseve dhe studimeve të ndryshme nga gjuha angleze në gjuhën shqipe:

August Strindberg, **E Forta**, dramë e përkthyer dhe e përshtatur nga anglishtja nga Besim REXHAJ; Loja, Nr. 3, **Revistë për Teatër**, Prishtinë, 2008;

Jerzy Grotowski, **Drejt një teatri të varfër** (Towards a poor Theatre), përkthyer nga anglishtja nga **Besim REXHAJ**, Loja, Nr. 4, **Revistë për Teatër**, Prishtinë, 2009;

Peter Brook, Grotowski, përkthyer nga anglishtja nga **Besim REXHAJ**, Loja, Nr. 4, **Revistë për Teatër**, Prishtinë, 2009;

Peter Brook, **Teatri i shenjtë** (Fragment), përkthyer nga anglishtja nga Besim **REXHAJ**, Loja, Nr.4, **Revistë për Teatër**, Prishtinë, 2009;

Peter Brook, **Teatri si mjet**, përkthyer nga anglishtja nga Besim **REXHAJ**, Loja, Nr.4, **Revistë për Teatër**, Prishtinë, 2009;

Peter Brook, **Artaud dhe enigma e madhe**, përkthyer nga anglishtja nga Besim **REXHAJ**, Loja, Nr.4, **Revistë për Teatër**, Prishtinë, 2009;

Peter Brook, **Grotowski ishte...**, përkthyer nga anglishtja nga Besim **REXHAJ**, Loja, Nr.4, **Revistë për Teatër**, Prishtinë, 2009;

Dialog midis Peter Brookut dhe Jerzy Grotowskit, udhëhequr nga Georges Banu, përkthyer nga anglishtja nga Besim **REXHAJ**, Loja, Nr.4, **Revistë për Teatër**, Prishtinë, 2009;

Kronologji 1955 – 1999, përpiluar nga Gregor Ziolkowski, përkthyer nga anglishtja nga Besim **REXHAJ**, Loja, Nr.4, **Revistë për Teatër**, Prishtinë, 2009;

11. Përvoja e punës:			
<i>Data:</i>	1990 – 1999		
<i>Vendi:</i>	Prishtinë		
<i>Emri i Institucionit:</i>	Fjala, Revistë për Kulturë, Art dhe Letërsi		
<i>Pozita:</i>	Redaktor		
<i>Përshkrimi:</i>	Redaktimi i teksteve botuese, pajisja me tekste si dhe, krahas shkrimeve autoriale, kultivimi i politikave redaktuese.		
<i>Data:</i>	1996 – 1997		
<i>Vendi:</i>	Prishtinë		
<i>Emri i Institucionit:</i>	Fakulteti i Arteve, Artet Dramatike,		
<i>Pozita:</i>	Bashkëpunëtor i jashtëm profesional		
<i>Përshkrimi:</i>	Ligjërimi lëndës Histori e dramës dhe e teatrit kombëtar		
<i>Data:</i>	1999 – 2003		
<i>Vendi:</i>	Prishtinë		
<i>Emri i Institucionit:</i>	UNMIK, Njësia e Përkthimeve		
<i>Pozita:</i>	Përkthyes, interpretues dhe revidues		
<i>Përshkrimi:</i>	Përkthimi i teksteve të ndryshme nga gjuha angleze në shqip dhe anasjelltas, interpretimi konsektiv, si dhe revidimi dhe redaktimi gjuhësor i teksteve të përkthyera.		
<i>Data:</i>	2003 – 2004		
<i>Vendi:</i>	Prishtinë		
<i>Emri i Institucionit:</i>	Bashkimi Evropian, Zyra e Kryeministrit, Projekt i GTZ-së		
<i>Pozita:</i>	Trajnues dhe Revidues gjuhësor		
<i>Përshkrimi:</i>	Trajnimi në fushën e përkthimit dhe të interpretimit i përkthyesve të Njesisë së Përkthimit pranë Zyrës së Kryeministrit si dhe revidimi i përkthimeve dhe redaktimi gjuhësor i tyre		
<i>Data:</i>	1999/2014		
<i>Vendi:</i>	Prishtinë		
<i>Emri i Institucionit:</i>	Fakulteti i Arteve, Drejtimi i Arteve Dramatike		
<i>Pozita:</i>	Nga Ligjëruesi e deri te Profesori i Asocuar,		
<i>Shkathësitë organizative dhe kompetencat:</i>	Shef i Katedrës së Dramaturgjisë së Drejtimit të Arteve Dramatike të Fakultetit të Arteve nga viti akademik 2012/3 e tutje		
<i>Shkathësitë kompjuteri dhe kompetencat:</i>	Word, shfrytëzimi i avancuar, komunikimi dhe shfrytëzimi i avancuar i Web Faqeve etj.		
<i>Shkathësitë të gjuhës: (1 deri 5: Ivlerësimi më i ulët - 5 fluent)</i>			
<i>Gjuha</i>	<i>Konverzimi</i>	<i>Shkrimi</i>	<i>Leximi</i>
Gjuha shqipe	5	5	5
Gjuha kroate-serbe	4	4	4
Gjuha angleze	4	4	4
<i>Shpërblimet dhe anëtarësimet:</i>	Për librin Drama shqiptare pas Luftës së Dytë Botërore, 1948 – 2008, Poetika, Tipologjia, Periodizimi, Faik Konica, Prishtinë, 2009 , shpërblimi “Pjetër Bogdani” i Lidhjes së Shkrimtarëve të		

	<p>Kosovës, si Libri më i mirë i vitit në të gjitha gjinitë letrare i botuar në vitet 2008/9.</p> <p>Jam anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës dhe Anëtar i Redaksisë për Arte Skenike të Fjalorit Enciklopedik të Kosovës të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës.</p>

DRAFT